



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1072/10 prot

Datë 29.06.2023

V E N D I M

Nr. 539/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.06.2023 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Meteo” SHPK, “Pastrime Silvio” SHPK, “Desaret Company” SHPK dhe “Alpen Pulito” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-63129-03-21-2023 me objekt “*Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 38,009,074 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Meteo” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Blv “Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë

Ankimues:

Operatori ekonomik “Silver” SHPK
Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Bajram Curri, Pallatet 1 Maji, Godina nr. 7, Shkalla 4, Kati 1-re, Tiranë

Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK

Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga Fatmir Haxhiu, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “Meteo” SHPK
Fshati "Cekin", Rruga Nacionale Gramsh Elbasan, ndërtesë private, zona kadastrale Nr. 1362, nr .pasurie 6/76, Elbasan

Operatori ekonomik “Desaret Company” SHPK
Njësia Bashkiake nr. 11, Rruga " Hysni Gerbolli", Pallati "Desaret",Prane Kryqit te Kuq, Kati përdhe, Tiranë

Operatori ekonomik “Alpen Pulito” SHPK
Lagja nr. 14, Rruga Tirana, Shkozet, Zona Kadastrale 8516, Godina nr. pasurie 16/201, Kati i pare, Durrës

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

1.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.03.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-63129-03-21-2023 me objekt “Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza””, me fond limit 38,009,074 lekë pa TVSH.

II.2. Në datën 12.04.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 26.04.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Meteo ” SHPK	28.548.556,40 lekë, kualifikuar
2. “AFA Grup” SHPK	30.397.931,00 lekë, skualifikuar
3. “Pastrime Silvio” SHPK	31.382.258,95 lekë, kualifikuar
4. “Desaret Company” SHPK	31.902.205,30 lekë, kualifikuar
5. “Alpen Pulito” SHPK	32.803.852,37 lekë, kualifikuar
6. “Silver” SHPK	34.496.853,40 lekë, kualifikuar
7. “Alko Impex Construction” SHPK	35.956.627,85 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 12.05.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 17.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1072 protokollit e operatorit ekonomik “Silver” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-63129-03-21-2023 me objekt “Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza””, me fond limit 38,009,074 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Meteo” SHPK, “Pastrime Silvio” SHPK, “Desaret Company” SHPK dhe “Alpen Pulito” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1072/2 prot, datë 18.05.2023, duke referuar kriteret të cilat operatori ekonomik “Silver” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë “Meteo” SHPK, “Pastrime Silvio” SHPK, “Desaret Company” SHPK dhe “Alpen Pulito” SHPK.

II.5.2. Në datën 23.05.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1072/3 prot., formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatori ekonomik i interesuar “Pastrime Silvio” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

II.5.3. Me anë të shkresës Nr.731/5 prot., datë 30.05.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.1072/4 prot., datë 01.06.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.6. Në datën 18.05.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1088 protokollu dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3111 e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-63129-03-21-2023 me objekt “Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’”, me fond limit 38,009,074 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Meteo” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1088/2 date 19.05.2023, duke referuar kriteret të cilat operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Meteo” SHPK.

II.6.2. Në datën 07.06.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1088/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 738/4 prot., datë 31.05.2023 drejtuar bashkëngjitur vendimi i KSHA-së me nr. 738/2 prot., datë 30.05.2023, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.7. Me shkresën nr. 1072/5 prot., datë 07.06.2023 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Silver” SHPK dhe operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë këtij Komisioni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë të paraqitur nga shoqëria “Meteo” SHPK që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

II.8. Në datën 08.06.2023 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 488/2023 si vijon:

- 1. Të urdhëroj paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, nga ana e shoqërive “Pastrime Silvio” SHPK, “Desaret Company” SHPK dhe “Alpen Pulito” SHPK, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-63129-03-21-2023 me objekt “Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza””, me fond limit 38,009,074 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.*
- 2. Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 13.06.2023.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.9. Në datën 13.06.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1072/7 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.731/8 prot., datë 12.06.2023 me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme” për QSU “Nënë Tereza”, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës.

II.10. Në datën 14.06.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1072/8 shkresa e shoqërisë “Pastrime Silvio” SHPK me datë 14.06.2023 me objekt: “Dërgohet dokumentacioni sipas kërkesës Vendimit nr.488/2023, me nr. 1072/6 prot., datë 08.06.2023”, bashkëngjitur dokumentacioni i shoqërisë “Pastrime Silvio” SHPK.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjerë të interesuara, përveç shoqërisë “Pastrime Silvio” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Silver” SHPK se: “[...] Operatori ekonomik “Meteo” SHPK, që nga dita e themelimit e deri më sot nuk e ka pasur në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit “Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme”, kjo na jep të drejtën të dyshojmë se ska pasur se si të kryejë dhe punë të ngjashme dhe të ketë kontrata të ngjashme”, si dhe pretendimet e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK se: “[...] ky operator (“Meteo” SHPK) nuk ka te perfshire ne objektin e aktivitetit te tij sherbimin e pastrimit sipas objektit te ketij prokurimi i cili eshte “Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme” per Qendren Spitalore Universitare “Nene Tereza” [...] rrjedhimisht dhe logjikisht, kuptohet qe ky operator nuk ka sherbime te ngjashme ne fushen e pastrimit te ambienteve te jashtme pasi, nje autoritet kontraktor nuk mund te kualifikoje nje operator qe nuk parashikon sherbimin e pastrimit ne objektin e veprimtarise se tij [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “a” e dokumentare të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
[...]

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1 e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*
 - a) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.*
 - b) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.*

III.1.3. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

III.1.4. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Meteo” SHPK rezulton se është paraqitur:

1. Shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, ku në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” është deklaruar si vijon:

Operatori ekonomik METEO SHPK është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Vertetuar me : Lloji i dokumentit: Ekstrakt i regjistrit tregtar, vertetim status aktiv Autoritetin ose organin lëshues: Qendra Kombëtare e Biznesit Adresën e ueb-it: <https://qkb.al> / <https://e-albania.al>

2. Kontratë me nr 1481 prot., datë 02.07.2021 me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për kantierin e punimeve për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe””, e lidhur me autoritetin kontraktor Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, me vlerë 17.357.000 lekë, pa TVSH. Kjo kontratë është shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Formular vlerësimi
 - b. Fatura Tatimore
 - c. Situacion përfundimtar

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Neni 41 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

III.1.7. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të

refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.9. Lidhur me pretendimet e ankimesve për sa i përket objektit të veprimtarisë së shoqërisë “Meteo” SHPK, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria në fjalë rezultojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në Pjesën II, “*Shkaqet e përjashtimit*”, gërma “A” “*Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit*”, është deklaruar: “*Operatori ekonomik METEO SHPK është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Vertetuar me : Lloji i dokumentit: Ekstrakt i regjistrit tregtar, vërtetim status aktiv Autoritetin ose organin lëshues: Qendra Kombëtare e Biznesit Adresën e ueb-it: <https://qkb.al> / <https://e-albania.al>.*” Gjithashtu nga verifikimi i Ekstraktit historik të regjistrit për të dhënat e subjektit “Meteo” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezultojnë se objekti i aktivitetit është përcaktuar: “*Ne fushen e ndertimit, punime e germime ne toke, ndertime civile e industriale, veshje fasadash, rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile, industriale. Ndertim rruge autostrada, mbikalime hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, punime nentokesore ura e vepra arti, ndertime ujesjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, ndertime detare dhe punime thellimi ne uje, punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime, punime te inxhinierisë mjedisit, punime per prishjen e ndertimeve, impianteve hidrosanitare kuzhina, laventeri, impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndriçuese, barrier dhe mbrojtje rrugore, ndertime parafabrikat beton arme, strukture metalike dhe druri, punime mbi shina e traversa, impiante te ndryshme elektrike , pastrim i ujerave detare liqenore dhe lumore, ndertimi i impianteve te ujit te pijshëm dhe pastrimi i tije, shpime gjeologjike dhe inxhinierike ne fushen e minierave , kerkim studim , shfrytezim dhe tregtim te mineraleve te dobishem. Ne fushen e transportit te mallrave dhe udhetareve, brenda dhe jashte vendit, ne fushen e tregetise me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore, industrial, te automjeteve e tregeti te tjera te lejuara nga ligji. Tregtimi i karburanteve te ndryshme, gazit te lengeshem. Ne fushen e shfrytezimit te pyjeve, perpunim lende druri, import eksport te materialeve drusore, ndertim rruge pyjore, permiresim pyjesh, ndertim vepra arti, sistemime malore, pyllzime e shfrytezim te qendrueshem. Shoqeria mund te kryeje edhe cdo lloje aktiviteti tjeter qe nuk eshte i ndaluar nga ligji shqiptar dhe qe ka lidhje te mjaftueshme me objektin e aktivitetit te saje. Financim, projektim, ndertim, vënie ne pune, shfrytezim, mirembajtje, administrim. Prodhim, furnizim, transmetim, instalim te prodhimit te energjise dhe veprave hidroenergjitike, shperndarja, inporti dhe eksporti, shitja e energjise*

elektrike te prodhuar. Kryerja e cdo aktiviteti qe i sherben realizimit te veprimtarise se shoqerise ne fushen e energjise. Transport mbetjesh jo te rrezikshme. Stacion transferimi mbetjesh jo te rrezikshme. Per tregtim te paisjeve spitalore dhe cdo aktivitet tjeter qe i sherben realizimit te kesaj veprimtarie. Ndertime per N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise. Import - eksport, prodhim dhe tregtim fidanesh, pemeve dhe lule dekorative.”

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Meteo” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar formulari i pergjithshëm i vetëdeklarimit, ku deklarohet se ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “Meteo” SHPK, sipas ekstraktit historik si më sipër cituar rezulton se përfshihet objekti i prokurimit.

Pretendimet e ankimesve nuk qëndrojnë

III.1.10. Lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Meteo” SHPK, në përmbushje të kriterit për shërbime të mëparshme të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës objektit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” KPP vlerëson, se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në Vendim të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “Meteo” SHPK si dhe situacionit përfundimtar, për kontratën me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për kantierin e punimeve për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe””, e lidhur me autoritetin kontraktor Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit

të dorëzuar ky i fundit dëshmon, se ka kryer shërbime mirëmbajtje të ndryshme si: shërbim mirëmbajtje impianti, mirëmbajtje e shtratit të kanaleve ekzistuese, të linjave të drenazhit të impiantit, drenazhime, mirëmbajtje rrugë komuniteti, mirëmbajtje e rrugëve të brendshme të impiantit, mirëmbajtje e pompave dhe pajseve mekanike të montuara në kantier, mirëmbajtje e rrjetit të furnizimit me energji dhe ndriçim të kantierit, mirëmbajtje e rrjetit të furnizimit me ujë, mirëmbajtje e rrethimit dhe portave të hyrjes në kantier, mirëmbajtje e zyrave. Nga shqyrtimi i zërave të situacionit përfundimtar rezulton se shoqëria “Meteo” SHPK ka përvojë të mëparshme vetëm për një zë të preventivit të shërbimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor për pastrimin e ambienteve të jashtme, që lidhet me shërbimin “*Mirëmbajtje e pusetave të ujërave të bardha*” të preventivit, ndërsa për zërat e tjerë të preventivit: *Pastrim i rrjetit rrugor + trotuare me krahë (fshesë) turni1; Prerje barishtesh në koordinatat e rrjetit rrugor; Larje e rrjetit rrugor me ujë nën presion; Larje e shesheve me ujë nën presion dhe Shërbim evadimi të mbetjeve urbane QSUNT - Landfill (3-4 herë/ditë sipas kërkesë së A.K)*, shoqëria në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument që dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për *shërbimin e pastrimit të ambjentëve të jashtme*, e cila referuar specifikimeve teknike dhe shërbimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit, ndryshe nga faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, në fokusin e saj ka si komponent kryesor *shërbimin e pastrimit të ambjentëve të jashtme të spitalit*.

Komponentët të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi, kërkojnë eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga shoqëria “Meteo” SHPK me anë të dokumentacionit të sipërcituar, referuar specifikimeve teknike dhe komponentëve përbërës të shërbimin e pastrimit. Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e eksperiencave të mëparshme nëse janë të ngjashme, nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë për shërbime, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën, duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të ofruar, duke nisur që nga objekti i kontratës së ofruar, rezulton, se kjo kontratë nuk mund të konsiderohet e ngjashme me objektin e prokurimit. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon, se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme. Operatori ekonomik “Meteo” SHPK duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Meteo” SHPK, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontrata me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje për kantierin e punimeve për projektin “Përmirësimi i sistemit të*

kanalizimeve të Tiranës së Madhe””, e lidhur me autoritetin kontraktor Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve dhe dokumentacioni që e shoqëron këtë kontratë, të paraqitura nga operatori ekonomik “Meteo” SHPK në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të kapacitetit teknik, për përvojat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit. Për sa më lart, pretendimet e ankimesve qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Silvio” SHPK se: “[...] licenca që OE “Meteo” SHPK ka paraqitur në SPE ... Kodi III.2.B nuk përmbush kriterin e kërkuar nga AK për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane pasi OE është i licencuar vetëm për transportin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe konkretisht është i licencuar për grumbullim dhe transport të përzierjeve të betonit, tullave, tjegullave, qeramikës, dherave dhe gurëve, lehtësisht e verifikueshme në Akt miratimin e licencës që po ju dërgojmë. Asnjë nga tipologjitë e mbetjeve që OE është i licencuar të transportojë nuk i përket objektit të prokurimit. Kërkesa është e qartë grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur (ne pronesi ose kontrate shërbimi) me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.

III.2.2. Në shtojcën 2 “Lista e Çmimeve” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Lista e Çmimeve

“SHËRBIM PASTRIMI I AMBJENTEVE TË JASHTME”, PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”						
NR	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia	Sasia	Frekuenca 24 muaj	Çmimi për njësi Leke pa TVSH	Vlera Totale Leke pa TVSH
1	Pastrim i rrjetit rrugor + trotuare me krahë (fshesë) turni 1	m2	34,623.7	730		
2	Pastrim i rrjetit rrugor + trotuare me krahë (fshesë) turni 2	m2	17,311	730		

3	<i>Prerje barishtesh në koordinatat e rrjetit rrugor</i>	<i>m2</i>	<i>350</i>	<i>16</i>		
4	<i>Mirëmbajtje e pusetave të ujërave të bardha</i>	<i>copë</i>	<i>100</i>	<i>24</i>		
5	<i>Larje e rrjetit rrugor me ujë nën presion</i>	<i>m2</i>	<i>29,485.1</i>	<i>240</i>		
6	<i>Larje e shesheve me ujë nën presion</i>	<i>m2</i>	<i>36,492.5</i>	<i>240</i>		
7	<i>Shërbim evadimi të mbetjeve urbane QSUNT - Landfill (3-4 herë/ditë sipas kërkesë së A.K)</i>	<i>kg</i>	<i>Deri ne 5000</i>	<i>730</i>		
<i>Fondi i marreveshjes kuader Leke (pa TVSH)</i>						<i>38,009,074</i>
<i>Çmimi Neto pa TVSH</i>						
<i>TVSH (%)</i>						
<i>Çmimi total me TVSH:</i>						
<i>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</i>						
<i>Nënshkrimi</i>						
<i>Vula</i>						
<i>Datë _____</i>						

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Meteo” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Licencë LN-6327-12-2018, datë 10.12.2020, Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “*Grumbullim dhe transportimi mbetjeve të parrezikshme*”.
- Akt-Miratimi “Licencë e kategorisë III.2.B”, datë 07.12.2018.

III.2.4. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.2.6. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.7. Në nenin 39 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

III.2.8. Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar, parashikohet se: “Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

III.2.9. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht:

“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”.

Ky ligj përcakton:

a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”

III.2.10. Në shtojcën 1, pika 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, përcaktohet: “17 Mbetje Nga Ndërtimet Dhe Prishjet (Përfshi Dhera Të Gërmuara Nga Zona Të Kontaminuara)”.

17 01	Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika
17 01 01	Beton
17 01 02	Tulla
17 01 03	Tjegulla dhe qeramika
17 01 06*	Përzierje ose fraksione të ndara betoni, tullash, tjegulla dhe qeramikës që përmbajnë substance të rrezikshme
17 01 07	Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06
17 02	Dru, qelqe dhe plastika
17 02 01	Dru
17 02 02	Qelqe
17 02 03	Plastikë
17 02 04*	Dru, qelq dhe plastika që përmbajnë substancë të rrezikshme
17 03	Përzierje bituminoze, bitumi dhe produkte të tjera të zifitit
17 03 01*	Përzierje bituminoze që përmbajnë zifte qymyri
17 03 02	Përzierje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01
17 03 03*	Zifte qymyri dhe katrane
17 04	Metale (përfshi dhe aliazhet e metaleve)
17 04 01	Bakër, bronx, tunxh
17 04 02	Alumin
17 04 03	Alumb
17 04 04	Zink
17 04 05	Hekur dhe çelik
17 04 06	Kallaj
17 04 07	Metale të përziëra
17 04 09*	Mbetje metalore të kontaminuara me substanca të rrezikshme
17 04 10*	Kabllo që përmbajnë naftë, bitum apo substanca të tjera të rrezikshme
17 04 11	Kabllo të tjera nga ato të përmendura në 17 04 10
17 05	Dhera (duke përfshirë dhera të gërmuara nga toka të kontaminuara, gurë dhe balta të tjera)
17 05 03*	Dhera dhe gurë që përmbajnë substancë të rrezikshme
17 05 04	Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03
17 05 05*	Balta që përmbajnë lëndë të rrezikshme
17 05 06	Balta, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 05
17 05 07*	Çakëll që përmban substanca të rrezikshme
17 05 08	Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07
17 06	Materiale izoluese dhe materiale ndërtimi me azbest

- 17 06 01* *Material izolimi që përmban azbest*
- 17 06 03* *Material izolimi që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme*
- 17 06 04 *Materiale izolimi të tjera nga ato të përmendura në 17 06 01 dhe 17 06 03*
- 17 06 05* *Materiale ndërtimi që përmbajnë asbest*
- 17 08 *Materiale ndërtimi me gips*
- 17 08 01 *Materiale ndërtimi me gips që janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme*
- 17 08 02 *Materiale ndërtimi me gips, të tjera nga ato të përmendura në 17 08 01*
- 17 09 *Mbetje të tjera ndërtimi dhe të prishjeve*
- 17 09 01* *Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë merkur*
- 17 09 02* *Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë PCB*
- 17 09 03* *Mbetje nga ndërtimi dhe të prishjeve, duke përfshirë mbetjet e përziara që përmbajnë substanca të rrezikshme*
- 17 09 04 *Mbetje të përziara nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03.*

20 *Mbetjet urbane shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mledhuar vecmas*

20 01 *Fraksionet e ndara (përveç 15 01)*

20 01 01 *Letër dhe karton*

20 01 02 *Qelq*

20 01 08 *Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat*

20 01 10 *Veshjet*

20 01 11 *Tekstile*

20 01 13 * *Tretësit*

20 01 14 * *Acidet*

20 01 15 * *Bazat*

20 01 17 * *Fotokimikatet*

20 01 19 * *Pesticidet*

20 01 21 * *Mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur*

20 01 23 * *Pajisje skarco që përmbajnë klorofluorokarbone*

20 01 25 *Vajra dhe dhjamëra ushqimore*

20 01 26 * *Vajra dhe dhjamëra, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 25*

20 01 27 * *Bojëra, ngjyra, ngjitës etj., që përmbajnë substanca të rrezikshme*

20 01 28 *Bojëra, ngjyra, ngjitës etj., të tjera nga ato të përmendura në 20 01 27*

20 01 29 * *Detergjent që përmbajnë substanca të rrezikshme*

20 01 30 *Detergjent të tjerë nga ato të përmendur në 20 01 29*

20 01 31 * *Medikamente citotoksike dhe citostatike*

20 01 32 *Medikamente të tjera nga ato të përmendura në 20 01 31*

20 01 33 * *Bateritë dhe akumulatorët të përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe bateritë e akumulatorët e pandarë*

20 01 34 *Bateritë dhe akumulatorët e tjerë nga ato të përmendur në 20 01 33*

20 01 35 * *Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21 dhe 20 01 23 që përmbajnë komponentë të rrezikshëm*

20 01 36 *Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35*

20 01 37 * Mbetje druri që përmbajnë substanca të rrezikshme
 20 01 38 Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37
 20 01 39 Plastikët
 20 01 40 Metalet
 20 01 41 Mbetjet nga pastrimi i oxhaqeve
 20 01 99 Fraksione të tjera të paspecifikuara
 20 02 Mbetjet e kopshteve dhe parqeve (përfshirë mbetjet e varrezave)
 20 02 01 Mbetje të biodegradueshme
 20 02 02 Dhera dhe gurë
 20 02 03 Mbetje të tjera të pabiodegradueshme
 20 03 Mbetje të tjera urbane
 20 03 01 Mbetjet e përziera urbane
 20 03 02 Mbetje nga tregjet
 20 03 03 Mbetje nga pastrimi i rrugëve
 20 03 04 Llumra nga gropat septike
 20 03 06 Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza
 20 03 07 Mbetjet të vëllimshme
 20 03 99 Mbetjet urbane të paspecifikuara

III.2.12.Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Meteo" SHPK, Komisioni konstaton, se ky operator ekonomik ka ngarkuar në SPE dokumentacionin - Licencë LN-6327-12-2018, datë 10.12.2020, Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë "Grumbullim dhe transportimi mbetjeve të parrezikshme" për vërtetueshmërinë e plotësimit të kriterit të veçantë të kualifikimit "Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë" Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur (ne pronesi ose kontrate sherbimi) me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B. Sipas Akt-miratimit të Licencës së kategorisë III.2.B, bashkëngjitur licencës, në pikën 4 "Kushtet e licencës", gërma "d" është parashikuar: *Subjekti të administrojë e të klasifikojë mbetjet e krijuara nga veprimtaria në përputhje (Vendimi nr.99, datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" shtojca 1)* ,

përfshirë vetëm mbetjet jo të rrezikshme.

17 01 07 Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06 (Përzierje ose fraksione të ndara betoni, tullash, tjegulla dhe qeramikës që përmbajnë substance të rrezikshme) dhe 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03 (Material izolimi që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme).

Pra subjekti në fjalë rezulton i licencuar për mbetje të tipit 17 Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara), ndërkohë që nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar në pikën 7 të formularëve 2 “Lista e çmimeve” dhe 6 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit” në dokumentet e tenderit zëri: “Shërbim evadimi të mbetjeve urbane QSUNT - Landfill (3-4 herë/ditë sipas kërkesë së A.K)”, shërbim i cili i referohet Tipit të mbetjeve 20 Mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Silver” SHPK qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK për sa i përket operatorit ekonomik “Meteo” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që operatori ekonomik “Meteo” SHPK nuk përmbush kriteret për eksperiencat e mëparshme e licencimin e shoqërisë dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshon gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Silver” SHPK se: “[...] operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK i ka të deklaruar dhe angazhuar si drejtuesin teknik e përgjegjës (Inxhinier Mjedisi, Kimist A.G dhe G.D), ashtu edhe mjetet (autobot që disponon me targë AA908TG, AA567XX) e deklaruar në këtë procedurë, në një kontratë tjetër që sapo ka lidhur me Tirana Agrikulture SHPK, Shoqëri Publike në varësi të Bashkisë Tiranë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2 dhe 3 e dokumenteve të tenderit, rezulton se është kërkuar si vijon:

2. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht **11 (njëmbëdhjetë)** persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

Nr.	Stafi	Nr.
1	Drejtues Teknik- me profil Inxhinier mjedisi	1 (një)
2	Përgjegjes me profil Inxhinier kimist ose Inxhinier mjedisi	2 (dy)
3	Punonjes shërbimi/Sanitar	6 (gjashtë)
4	Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara	2 (dy)
	Totali i punonjësve	11 (njëmbëdhjetë)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Për Drejtuesin Teknik, me profil - Inxhinier mjedisi OE duhet të paraqes:
- Diplomë me profesion Inxhinier mjedisi.

- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencen perkatese.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.
- Per punonjësit Pergjegjes me profil Inxhinier mjedisi, te paraqitet:
 - Diplomë me profesion Inxhinier mjedisi.
 - Duhet të ketë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e – albania.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencen perkatese.
- Pergjegjesit nuk duhet te jene te angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhes se realizimit te objektit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.
- Per punonjësit punonjes sherbimi/Sanitare, te paraqitet vetem kontrate pune perkatese (dy prej tyre te jene te pajisur me Leje Drejtimi në përputhje me mjetet e kërkuara, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

Shënim: Punonjës Shofer, mund të jetë cilido nga punonjësit e OE, mjafton dy prej tyre të jenë të pajisur me Leje Drejtimi në përputhje me makineritë/pajisjet e kërkuara, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes
----	--------------	------------	---

Shenim: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë dokumentacionin e kerkuar te cdo punonjesi prane AK.

***Shenim 4.1:**

Me qellim garantimin e gjithesepshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperme jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Stafi i percaktuar ne tabelën e mesiperme me nr 2, 3, 4 te cilet do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor, per zbatimin e kesaj kontrate, nuk duhet te jene te angazhuar ne kontrata te tjera, deri ne perfundim te kontrates. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.

Rastet e deklaratave te rreme, do te konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

3. Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
----	---------------	--------	-----------------	---------

1	Makine teknologjike transportuese e mbetjeve urbane, me kapacitet jo me te vogel se 2 ton, me ngjeshje.	copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira
2	Makine per larjen e rrugeve (Autobot) te pajisur me pompe per larjen e rrugeve me presion, me kapacitet mbajtes minimumi 7000 deri ne 8000 litra ujë.	copë	1 (nje)	Në pronësi ose me qira

Shënim 5.1:

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit duhet te paraqesi prane AK dokumentacionin për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Autoriteti Kontraktor, pas dorezimit te dokumentacionit te mesiperme do te verifikojë prane ambienteve te operatorit disponueshmerine e pajisjeve e deklaruar.

Mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Rastet e deklarave te rreme, do te konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

III.4.2. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----

<i>Përfaqësuesi (emri):</i>	-----
<i>Telefoni:</i>	-----
<i>E-mail:</i>	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin*

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT – i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i>

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<i>Deklarata</i>

<p><i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</i></p> <hr/> <p><i>etj.</i></p> <p><i>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
- 3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
- 4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
- 5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.**
- 6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;**

b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*



7. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*

a) *çmimet;*

b) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*

c) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*

d) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

8. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*

9. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijsëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të

Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.*

- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ Profili i punonjësve _____ <u>Makineri e mjete</u>

	Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetëdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.4.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK në përmbushje të kriterëve sa më sipër, për sa i përket punonjësve të kërkuar, ka dorëzuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojcën 9), të plotësuar prej tij si dhe ka paraqitur deklaratë me datë 12.04.2023 mbi stafin, drejtuar A.SH.P.P, ku ka deklaruar se disponon punonjësit e kërkuar: drejtuesin teknik, dy përgjegjës, 10 punëtorë dhe 3 shoferë. Gjithashtu përfaqësuesi ligjor i shoqërisë ka deklaruar se përgjegjësit dhe punonjësit e deklaruar nuk janë/nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit.

III.4.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.4.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin**

përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”

III.4.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.4.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**”

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.4.8. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “c” dhe “ç” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose “[...]”

III.4.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera, nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Për përmbushjen e kriterit për kualifikim autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të kenë minimalisht 11 (njëmbëdhjetë) persona të punësuar, 1 drejtues teknik, 2 përgjegjës me profil inxhinier kimist ose inxhinier mjedisi, 6 punonjës shërbimi/sanitar dhe 2 shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara. Për përgjegjësit autoriteti kontraktor ka kërkuar që nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë realizimit të kontratës. Gjithashtu është kërkuar që: “Stafi i përcaktuar në tabelën e mesiperme me nr 2, 3, 4 të cilet do të paraqiten Autoritetit Kontraktor, për zbatimin e kësaj kontrate, nuk duhet të jene të angazhuar në kontrata të tjera, deri në përfundim të kontrates. Për këto arsye të paraqitet deklarate perkatëse nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë.”

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, për sa i përket stafit teknik, Komisioni Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor në seksionin shënime 4.1 ka përcaktuar se, stafi i cili do t'i paraqitet Autoritetit Kontraktor, për zbatimin e kësaj kontrate, nuk duhet të jetë

i angazhuar në kontrata të tjera, deri në përfundim të kontratës, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar, se stafi i cili do t'i paraqitet autoritetit kontraktor për zbatimin e kësaj kontrate nuk duhet të jetë i angazhuar gjatë realizimit të kontratës deri në përfundim të kontratës, por nuk përcaktohet që nuk duhet të jetë i angazhuar në momentin e dorëzimit të ofertave, pra ky detyrim lind ex post, pas lidhjes së kontratës.

Për sa i përket pretendimeve të ankimuesit për makineritë, në dokumentet e tenderit, nuk është parashikuar nga autoriteti kontraktor ndonjë kërkesë për angazhimin e mjeteve, e cila do të përbënte detyrim për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Silver" SHPK për sa i përket vendimit të KVO-së për kualifikimin e shoqërive "Desaret Company" SHPK dhe "Alpen Pulito" SHPK në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, nëpërmjet vendimit nr. 488/2023, datë 08.06.2023 Komisioni i Prokurimit Publik urdhëroi shoqëritë "Pastrime Silvio" SHPK, "Desaret Company" SHPK dhe "Alpen Pulito" SHPK të paraqesin dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit "*Procedurë e hapur*", me Nr. REF-63129-03-21-2023 me objekt "*Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*", me fond limit 38,009,074 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara. Në kushtet kur operatorët ekonomikë "Desaret Company" SHPK dhe "Alpen Pulito" SHPK nuk bashkëpunuan me KPP-në, pasi nuk paraqitën dokumentacionin e kërkuar me vendimin e sipërcituar, ky Komision nuk mund të shprehet lidhur me pretendimet e ankimuesit për subjektet në fjalë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 "*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Silver” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-63129-03-21-2023 me objekt “*Shërbim pastrimi i ambienteve të jashtme, për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, me fond limit 38,009,074 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Meteo SHPK, duke e skualifikuar këtë operator.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Silver” SHPK dhe operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri